



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURA MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jednica Org.Unit	DPHINB
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	01
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	9079/25
Data: Datum: Date:	22.12.25
PRISHTINË / A	
No. 1	

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Komisioni Ministror për Themelimin e Odës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit

Bazuar në nenin 7, paragrafët 3,4,5,6 dhe nenin 43, paragrafin 3, nënparagrafin 3.6 të Ligjit Nr.08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, dhe bazuar në vendimet e Ministrit nr. 5687/25 të datës 27.05.2025 për formimin e Komisionit Ministror për Themelimin e Odës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit dhe të vendimit nr. 5687/25 -2 të datës 12.12.2025 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të Ministrit nr. 5687/25 të datës 27.05.2025, Komisioni Ministror për Themelimin e Odës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, në mbledhjen e mbajtur më 22.12.2025 merr:

V E N D I M

I. Për dhënien e Pëlqimit për Projekt Rregulloret:

1. Projekt Rregullore e Punës së Kuvendit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, dhe
2. Projekt Rregullore për Organizimin e Brendshëm të Administratës së Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës.

II. Projekt Rregulloret sipas pikës I. të këtij Vendimi procedohen për miratim në Kuvendin e Odës së Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

A R S Y E T I M

Komisioni Ministror për Themelimin e Odës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, pas shqyrtimit të Kërkesës për marrjen e pëlqimit me nr. prot. 9039/25 datës 18.12.2025 si dhe në mbështetje të nenit 7 paragrafit 4 dhe 6 të Ligjit Nr.08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit lëshon pëlqimin.

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka drejtë të ushtroj ankesë në Ministri në Komisioni për ankesa ndaj vendimeve të Komisionit Ministror për themelimin e Odave në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së Vendimit.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Anëtarëve të Bordit Drejtues të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës;
- Arkivit të MMPHI-së.

Xhemal Metolli, Kryesues

Komisioni Ministror për Themelimin e Odës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit

